



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 mars 2013
Nr. ref.: RK391/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI14/13

Parashtrues

Komuna e Podujevës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, Rev. nr. 50/2011, të 22 nëntorit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Kërkesa është parashtruar nga Komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejme: Parashtruesi), përfaqësuar nga z. Faik Rama.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 50/2011, të 22 nëntorit 2012, që iu dorëzua parashtruesit më 26 dhjetor 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se aktgjykimi i lartpërmendur ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 46 [Mbrojtja e Pronës], dhe të drejtën e garantuar nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), respektivisht nenin 1 të Protokollit 1 (Mbrojtja e Pronës).
4. Më tej, parashtruesi kërkoi vendosjen e masës së përkohshme *“për të ndaluar ekzekutimin e Aktgjykimit Rev. nr. 50/2011 të Gjykatës Supreme, sepse ekziston rreziku që paditësi të kërkojë ekzekutimin e detyrueshëm të Aktgjykimit Rev. nr. 50/2011 dhe, në këtë mënyrë, të shkaktojë dëme të pariparueshme ndaj të paditurit dhe të cenojë interesin publik”*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenin 22 e në nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); si dhe rregullin 54, rregullin 55 dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 5 shkurt 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 25 shkurt 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. GJR. KI14/13, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. KSH. KI4/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
8. Më 26 janar 2013, Gjykata kërkoi nga z. Faik Rama të dorëzojë një autorizim, të cilin ai e dorëzoi në Gjykatë.
9. Më 27 janar 2013, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme.
10. Më 12 mars 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

11. Më 28 korrik 1980, Seksioni pronësor-juridik i Kuvendit Komunal të Podujevës, mori Vendimin nr. 04-466-765/3 për eksproprijimin e pronës së paluajtshme të

pronarëve privatë për nevoja dhe për interesa të Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI), për të ndërtuar një shtëpi të kulturës në Podujevë. Një nga pronat e ekspropriuara i përkiste Z. (Xh.) A.

12. Më 11 gusht 1980, Z. (Xh.) A. u ankua në Drejtorinë Krahinore për Çështje Pronësore-Juridike në Prishtinë, kundër vendimit për eksproprijim.
13. Më 27 tetor 1980, Sekretariati për Ekonomi i Kuvendit Komunal të Podujevës (Vendimi nr. 04-360-547) ia ndau Z. (Xh.) A. një banesë dydhomëshe.
14. Më 27 tetor 1980, Banka Themelore në Prishtinë nxori një garanci me të cilën Kuvendi Komunal i Podujevës garanton se ka siguruar mjetet për eksproprijimin e tokës për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës.
15. Më 31 tetor 1980, u lidh një marrëveshje ndërmjet Z. (Xh.) A. dhe Seksionit pronësor-juridik të Kuvendit Komunal në Podujevë për lëshimin e ndërtesës së eksproprijuar, si dhe për ndarjen e truallit dhe të lokalit për veprimtari private, ndërkaq nuk u arrit asnjë marrëveshje për çmimin e kompensimit.
16. Më 5 nëntor 1980, Seksioni pronësor-juridik i Kuvendit Komunal të Podujevës nxori një konkludim për lejimin e ekzekutimit të Vendimit të plotfuqishëm nr. 04-466-765/3, të 28 korrikut 1980.
17. Më 6 nëntor 1980, Seksioni pronësor-juridik i KK të Podujevës nxori një vendim (Vendimi nr. 04-4784) për lejimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 04-466-765/3, të 28 korrikut 1980.
18. Më 25 nëntor 1980, Seksioni pronësor-juridik i KK të Podujevës mbajti një shqyrtim me gojë, përkitazi me caktimin e çmimit të kompensimit.
19. Më 9 janar 1981, Sekretariati për Ekonomi i KK të Podujevës (Vendimi nr. 04-351-4919) miratoi kërkesën e Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI), për të filluar ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës.
20. Më 9 maj 1981, Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit (BVI) nxori një garanci, ku garanton se ka siguruar mjetet për investim.
21. Më 21 maj 1981, Seksioni pronësor-juridik i KK të Podujevës (Vendimi nr. 04-466-765/3) nxori një konkludim për të urdhëruar Z. (Xh.) A. që të lëshojë pronën e eksproprijuar dhe të shpërngulet në banesën dydhomëshe që i ishte ndarë. Kundër këtij vendimi Z. (Xh.) A. u ankua në Drejtorinë Krahinore për Çështje Pronësore-Juridike në Prishtinë.
22. Më 22 maj 1981, Seksioni pronësor-juridik i KK të Podujevës (Vendimi nr. 04-360-204) ndau një banesë njëdhomëshe për Z. (Xh.) A.
23. Më 22 dhjetor 1982, Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike në Prishtinë (Vendimi nr. 03-466-576/82) hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e Z. (Xh.) A., sepse atij i ishte ndarë një banesë dhe ishte arritur marrëveshja për kompensim.

24. Më 4 maj 1983, Kuvendi Komunal në Podujevë dhe Z. (Xh.) A. lidhën një marrëveshje, me të cilën Kuvendi Komunal i Podujevës u obligua të sigurojë lokalitetin për Z. (Xh.) A. për të udhëhequr veprimtarinë.
25. Më 21 korrik 1995, Kuvendi Komunal i Podujevës nxori një vendim për përcaktimin e përmbajtjes së aktvendimit të plotfuqishëm për ekzekutimin, për eksproprijimin dhe për marrjen e pronësisë së pronës së paluajtshme dhe konfirmoi që ngastrat: 554, 555 dhe 556, kishin kaluar në pronësi të Komunës si pronë shoqërore.
26. Në prill të vitit 2001, ngastrat e kontestuar: 554, 555 dhe 556, ishin regjistruar në emër të Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI), në bazë të Vendimit të plotfuqishëm të Seksionit pronësor-juridik të KK të Podujevës, Vendimi nr. 04-466-765/3, i 28 korrikut 1980.
27. Në vitin 2003, ngastrat e kontestuar: 554, 555 dhe 556, u regjistruan në pronësi të Komunës së Podujevës.
28. Më 15 mars 2006, trashëgimtarët e Z. (Xh.) A. parashtruan një padi në Gjykatën Komunale në Podujevë kundër Komunës së Podujevës për vërtetimin e pronësisë mbi ngastrat: 554, 555 dhe 556, e cila ishte pronare e këtyre ngastrave në bazë të listës poseduese të vitit 2001. Trashëgimtarët pohonin se këto ngastra gjenden në një zonë ku ishte një ndërtesë e papërfunduar dhe Komuna e Podujevës ua kishte pamundësuar posedimin dhe shfrytëzimin e tyre.
29. Më 2 korrik 2007, Gjykata Komunale e Podujevës (Aktgjykimi C. nr. 122/2006) hodhi poshtë ankesën e trashëgimtarëve si të pabazuar. Gjykata Komunale konstatoi se:
 - Më 28 korrik 1980, Seksioni pronësor-juridik i KK të Podujevës nxori Vendimin nr. 04-466-765/3, për eksproprijim;
 - Në vitin 2001, ngastrat e eksproprijuara u regjistruan në emër të Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI) dhe, në vitin 2003, Komuna e Podujevës u regjistrua si pronare e ngastrave.Kështu, Gjykata Komunale vendosi që ankesa e trashëgimtarëve ishte e pabazuar. Ndaj këtij aktvendimi, trashëgimtarët u ankuan në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
30. Më 22 tetor 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Vendimi Ac. nr. 821/2007) anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Podujevë dhe e ktheu për rigjykim. Gjykata e Qarkut konstatoi se Gjykata Komunale duhet të konfirmojë si në vijim:
 - Sipas cilës bazë juridike është regjistruar në vitin 2001 prona e paluajtshme e kontestuar në pronësi të Z. (Xh.) A.;
 - Në çfarë baze juridike ishte regjistruar pastaj prona e paluajtshme në pronësi të Komunës së Podujevës; dhe

- A ishte transferuar prona e paluajtshme e kontestuar, në pronësi dhe në shfrytëzim të përfituesve të pronës së eksproprijuar, pas aktgjykimit të plotfuqishëm për shpronësimin në bazë të qëllimit të eksproprijimit.
31. Më 24 shkurt 2010, Gjykata Komunale e Podujevës (Aktgjykimi C. nr. 879/2008) miratoi ankesën e trashëgimtarëve dhe konfirmoi se ata janë pronarë të ngastrave të kontestuara. Gjykata Komunale konstatoi: *“Ishte konfirmuar fakti se qëllimi i eksproprijimit nuk ishte arritur, sepse ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës kishte filluar, por nuk kishte përfunduar ende dhe ky ndërtim nuk i shërbente të paditurit për qëllimin që ishte eksproprijuar”*. Gjykata Komunale, po ashtu, konstatoi se, në bazë të dëshmive të dëshmitarëve, paraardhësit e trashëgimtarëve kurrë nuk ishin kompensuar për eksproprijimin. Ndaj këtij aktgjykimi, parashtruesi u ankua në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
 32. Më 31 janar 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi Ac. nr. 490/2010) aprovoi ankesën e parashtruesit dhe ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Podujevë, duke i dhënë të drejtë parashtruesit si pronar i ngastrës së kontestuar. Gjykata e Qarkut konstatoi: *“[...] Gjykata e shkallës së parë lidhur me këtë lëndë kontestimore ka marrë qëndrim të gabuar përkitazi me vlerësimin e fakteve të paraqitura dhe si pasojë e saj aktgjykimi ankimor është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale”*. Gjykata e Qarkut më tej konstatoi se në bazë të Vendimit nr. 04-466-7653/3 të 28 korrikut 1980 prona është eksproprijuar me kompensim parathënës të paditësve ku i njëjti aktvendim e ka marrë formën e prerë më datën 22 dhjetor 1982 dhe objekti Shtëpia e Kulturës është ndërtuar në pronën e lartpërmendur. Gjykata e Qarkut gjithashtu ka vërtetuar se trashëgimtarët nuk kanë bërë kërkesë për eksproprijim e as kërkesë për anulimin e aktvendimit për eksproprijim. Trashëgimtarët kanë parashtruar një kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër këtij aktgjykimi”.
 33. Më 22 nëntor 2012, Gjykata Supreme aprovoi kërkesën për revizion dhe ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut si dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 24 shkurtit 2010. Gjykata Supreme konstatoi: *“[...] Qëndrimi juridik i shkallës së parë është i drejtë, ngase aktvendimi mbi eksproprijimin është marrë në vitin 1980, ndërsa vendimi mbi vërtetimin e plotfuqishmërisë së aktvendimit për eksproprijimin është i datës 21 korrik 1995, që do të thotë se gjykata e shkallës së dytë gabimisht konstaton se aktvendimi mbi eksproprijimin ka marrë formën e prerë më 22 dhjetor 1982. Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vërtetuar faktin me administrimin e provave – me dëgjimin e dëshmitarëve që paraardhësit të paditësve nuk i është paguar kurrfarë kompensimi për ngastrat e eksproprijuara, sepse pas 23 viteve këto ngastra janë regjistruar si pronë shoqërore. Në këtë rast fakti relevant është që e paditura nuk ka prezantuar as nuk ka provuar me asnjë provë që paraardhësit të paditësve i është kompensuar prona për eksproprijim”*. Më tej, Gjykata Supreme konstatoi se parashtruesi nuk ka dorëzuar/paraqitur asnjë provë se prona e eksproprijuar ishte shfrytëzuar për qëllimin për të cilin ishte eksproprijuar”.

Pretendimet e parashtruesit

34. Parashtruesi pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe me aktgjykimin e Gjykatës Komunale ishin bërë shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ-së.

Pranueshmëria e kërkesës

35. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, është e domosdoshme që së pari të vlerësohet nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
36. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet rregullit 36.1 (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton që *“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar”*.
37. Gjykata thekson që nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet faktike apo juridike (ligjshmëria), që pohohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç dhe deri në masën që mund të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Kështu që, kjo Gjykatë nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur trajton vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I*).
38. Me fjalë të tjera, Gjykata mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë prezantuar në atë mënyrë që, procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë ndërmarrë në atë lloj mënyre që parashtruesi të ketë gëzuar një gjykim të drejtë (*Shih, ndër dokumente të tjera, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991*).
39. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thjesht konteston nëse Gjykata Supreme ka zbatuar tërësisht ligjin e aplikueshëm dhe nuk pajtohet me gjetjet faktike të gjykatave përkitazi me rastin e tij.
40. Në këtë kuptim, parashtruesi nuk ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese, si dhe nuk ka ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tij janë cenuar nga autorit publik. Kështu që, Gjykata Kushtetuese nuk gjen bazë për të vendosur që procedurat përkatëse kanë qenë në një mënyrë, apo në mënyrën tjetër, të padrejta apo arbitrare (*Shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009*).
41. Kështu, parashtruesi nuk ka dëshmuar se pse dhe si janë shkelur nga Gjykata Supreme të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë. Gjykata vëren se aktgjykimet e Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës Komunale, të 24 shkurtit 2010, ishin mirë të argumentuara dhe të arsyetuara.

42. Rrjedhimisht, kërkesa është e papranueshme, sepse është qartazi e pabazuar, në bazë të rregullit 36.1 (c) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

43. Neni 27 i Ligjit dhe, në veçanti, rregulli 54.1 i Rregullores së punës, parasheh: “Në çfarëdo kohe, përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme”.
44. Megjithatë, duke pasur parasysh se kërkesa u gjet si e papranueshme, parashtruesi i kërkesës nuk ka të drejtë, sipas rregullit 54.1 të Rregullores së punës, të kërkojë masë të përkohshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të rregullit 36.1 (c), të rregullit 54 dhe të rregullit 56. 2 të Rregullores së punës, më 12 mars 2013, njëzëri

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T’ua komunikojë vendimin palëve dhe ta publikojë vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtare raportuese


Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani